

PROCESVERBAL

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Blerje bileta udhëtimi Tiranë – Bruksel - Tiranë” copë 1(një)

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 34980000-0

Në bazë të nenit 21, pika 2, nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” (në vijim “LPP”), si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti kontraktor Instituti i Shëndetit Publik ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e kërkesave specifike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

Operatori ekonomik i renditur i pari, përpara se të shpallet fitues, duhet të dorëzojë, dokumentet si më poshtë:

- Rezervimi i biletës sipas destinacionit të kërkuar;
- Operatori duhet të ketë çertifikatën e akreditimit ose një vërtetim nga IATA (Shoqata ndërkombëtare e Transportit Ajror)
- Vërtetim bankar (IBAN)
- Të kryhet check-in për personin që do të udhëtojë
- Rezervimi i vendeve
- Operatori ekonomik, nëpërmjet një deklarate me firmën dhe vulën e subjektit, duhet të marrë përsipër se angazhohet me përgjegjësi të lartë për zgjidhjen e problemeve lidhur me vonesat e fluturimeve, humbjen e bagazheve, sendeve të tjera si dhe cdo rast tjetër të paparashikueshëm.

Operatori ekonomik duhet të përgjigjet brenda 1 (nje) ore nga njoftimi i fituesit. Dokumentacioni kërkuar të dorëzohet në adresën www.app.gov.al Mos përgjigja do të jetë kusht për skualifikim.

Shënim: Operatori ekonomik fitues për nënshkrimin e një kontrate/dorëzimin e faturës tatimore duhet të ketë:

- Kopje të certifikatës Elektronike të Fiskalizimit, për tatimpaguesit që përdorin Platformën Qendrore të Faturave;

- Kopje të Certifikatës Elektronike të Fiskalizimit dhe kopje të vlefshme të kontratës së lidhur me Kompaninë e Certifikuar për zgjidhjen softuerike në përdorim, për tatimpaguesit që lëshojnë fatura përmes zgjidhjes sotuerike.

Në ofertën e tij, ofertuesi duhet të paraqesë të dhënat e plota të personit të kontaktit.

Argumentimi: Me qëllim që itinerari i biletës së udhëtimit, të jenë në përputhje me këkesat specifike, është kërkuar që *ofertuesi i cili ka marrë njoftimin e shpalljes fitues nga sistemi i prokurimit elektronik të dorëzojë deklaratën e sipërcituar.*

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”:

Referuar shkresës Nr. 827 Prot., datë 17.08.2023, Autorizim për shërbim jashtë vendi, janë hartuar kërkesat specifike si më poshtë vijon

1. **Tiranë – Bruksel - Tiranë** 1 (një) biletë për të rritur
Nisja nga Tirana në Bruksel, **Datë 27.09.2023**
Kthimi nga Brukseli në Tiranë **Datë 30.09.2023**
2. Bagazhe doretë përfshira
3. Klasi ekomomik
4. Udhëtimi të jetë direkt.

Në përfundim të hartimit të kërkesave të veçanta për kualifikim, KPVV-ja vendos që, sipas miratimit të Ftesës për Ofertë nga titullari i Autoritetit Kontraktor, të vijojë me hedhjen në Sistemin e Prokurimit Elektronik të procedurës së prokurimit, ngarkohet për këtë znj. Lindita Kokona.

KOMISIONI I PROKURIMIT TË SISTEMIT DINAMIK TË BILETAVE TË TRANSPORTIT AJROR NDËRKOMBËTAR